



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.69/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Lazic dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me zyrtarin ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Malishevë, për shkak të pengimit të tubimit elektoral për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**Konstatohet si e tërhequr** ankesa Anr. 69/2017, e datës 05.06.2017, e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë.

#### A r s y e t i m

Me datën 05.05.2017, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendohet se në fshatin Shkozë, Komuna e Malishevës, një person me emrin Leotrim Tahir Bytyqi, i shoqëruar me një person tjetër i cili person kishte ofenduar subjektin në fjalë, mirëpo identiteti i personit nuk është i ditur dhe prej subjektit supozohet se është nxitur nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, pasi që njëri nga personat është kushëri i ish-deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovë.

PZAP-i, në kuptim të nenit 6, paragrafi 3, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në shkresën me nr. protokollit 69/2 të datës 05.06.2017, kërkoi nga parashtruesi i ankesës për ta plotësuar ankesën Anr. 69/2017 të datës 05.06.2017, gjegjësisht që ta specifikoj saktësisht se me cilin person ishte Leotrim Tahir Bytyqi i cili ka penguar tubimin elektoral në fshatin Shkozë, Komuna Malishevë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj shkresat e lëndës konstaton se ankesa e tillë konsiderohet se **është tërhequr** për këto arsye:

PZAP-i konsideron se përkundër kërkesë së bërë ndaj parashtruesit të ankesës lidhur me plotësimin e ankesës ashtu siç edhe parashihet me dispozitat e nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, parashtruesi i ankesës në plotësimin e kërkuar nuk ka përmbushur elementet e kërkuar sipas rekomandimeve të PZAP-i.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë, bazuar në nenin 6 par.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it lidhur me nenin 118 par. 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

Anr.69/2017 më datën 06.06.2017.



**Kryesuesi i Panelit  
Fejzullah Rexhepi**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.